



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN

PËR

“DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESEM 2026-2028 TË BASHKISË SHKODËR”

Konsultim publik : Rajoni nr.3.

Data : 19.09.2025

Ora : 13.00

Vendi: Salla e Këshillit Bashkiak

Numri i pjesëmarrësve : *Numri i pjesëmarrësve 27, nga të cilat 15 gra.*

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : *Për draft projekt planin buxhetor afatmesem 2026-2028 të Bashkisë Shkodër.*

Pjesëmarrës : Drejtues dhe specialistë të administratës së Bashkisë Shkodër dhe banorë (Bashkangjitur listë prezenca).

Takimi drejtohet nga **Zv.Kryetarja e Bashkisë**, e cila bën një prezantim të shkurtër në lidhje me :

- ✦ Projekt-aktin e propozuar
- ✦ Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- ✦ Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- ✦ Dha informacion për mënyren e dhënies së rekomandimeve.
- ✦ Ju dha fjalën pjesëmarrësve

Pjesëmarrësit që morrën fjalën dhe diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet janë si vijon :

Fjalën e merr fillimisht **Z.Anton Deda**, administrator i Rajonit nr.3 i cili bën një përmbledhje të punëve dhe investimeve të kryera për lagjen nr.3 të qytetit, duke theksuar faktin që ai është gjithmonë në kontakt e në biseda me çdo banor të këtij rajoni dhe çdo rrugë është në monitorim të vazhdueshëm për sa i përket ndriçimit, pastrimit apo çdo nevojë të zonës.

Më pas fjalën e merr **Zv.Kryetarja e Bashkisë Znj.Qyteza**, e cila falënderon të pranishmit për të qenurit aktiv në këto takime. Kjo tregon, shton ajo edhe besueshmëri tek Bashkia dhe punët që realizojmë së bashku. Bashkia është shumë e interesuar që çdo zonë të jetë në fokusin e saj sipas nevojave që janë në terren. Ajo gjithashtu shton se për një kohë shumë të shkurtër kemi arritur të bëjmë punë të mira dhe mirëpresim nga ju propozimet për buxhetin e ardhshëm të Bashkisë Shkodër. Ajo shton se sigurisht duhet të mbajmë në konsideratë edhe të ardhurat që merren nga kjo zonë, të cilat përkthehen edhe në investime për zonën.

Rajoni nr.4 përfshin një zonë shumë të rëndësishme dhe çdo ndërhyrje e bërë ka shumë rëndësi dhe impakt të lartë për të gjithë qytetin. Prandaj sot kërkojmë nga ana juaj që të jeni aktiv duke pasqyruar problematikat të cilat do të merren në konsideratë me përgjegjësi nga ana jonë.

Z. Bardhok Martini, banor i lagjes Skenderbeg:

- Jemi rreth 10 familje tek rrugica e Poligonit dhe të gjithë kemi gropa septike sepse nuk ka kanalizime në këtë rrugë.
- Është vendosur ndriçimi por emergjente kemi realizimin e kanalizimeve dhe ujësjellësit në këtë rrugë.
- Po ashtu kemi nevojë që të shtohen kazana.mbeturinash.

Administratori është në dijeni të rrugës që po diskutojmë dhe është e nevojshme të kemi bashkëpunimin tuaj për këtë rrugë. Është viti i katërt që bëhet kjo kërkesë dhe shpresojmë që të përfshihet në buxhet.

Nga administrata sqaron **Z. Altin Salihi** duke thënë se problematika në këtë zonë ka të bëjë me faktin që është zonë informale. Përsa i përket pastrimit do të përpiqemi të shtojmë një kazan mbeturinash. Edhe problematikën e ujërave të zeza do ta transferojmë pranë ujësjellësit.

Banor, Lagjja “Fahri Ramandani”:

- Në Rus kemi probleme me oborrin përpara shtëpisë me ujërat gjatë rreshjeve. Nuk mund të kalohet dhe është e zënë edhe hapësira për të hyrë dhe dalë nga shtëpitë.
- Çdo ditë kemi debate me tregtarët aty sepse zënë edhe trotuarin. Duhet komunikuar me Policinë Bashkiake për të patur kontroll të vazhdueshëm.

Administratori **Z.Anton Deda** sqaron se bëhet fjalë për zonën, ku janë bërë investimet me kapota për pallatet dhe është sistemuar i gjithë sheshi në atë zonë.

Znj.Ardiana Lepuri, drejtoreshë shkolla “Pashko Vasa” shprehet se kemi pasur një bashkëpunim shumë të mirë deri tani me DMNOP dhe i falënderon për këtë. Ajo shpreh edhe disa problematika:

- Është mbyllur dalja në oborr që kemi pasur në oborrin e shkollës nga një lokal.
- Ka vite që nuk ka investime në shkolla dhe e kuptojmë këtë gjë. Kemi vite që nuk kemi patur asnjë rikonstruksion të shkollës, vetëm mirëmbajtje të vogla.
- Mendoj që është një shkollë që meriton të ketë një lyerje totale të shkollës.

- Duhet ndërhyrje në tualete dhe mirëmbajtje të suvatimeve.
- Ka nevojë të shihet terraca përpara shkollës.
- Edhe një tjetër problematikë ka të bëjë me furnizimin me ujë në këtë shkollë sepse gjatë verës nuk kemi ujë mjaftueshëm gjatë verës.

Z. Gjozef Kullaj nga administrata shprehet se do të marrim masa që t'i kemi prioritet këto nevoja që paraqitet.

Banore, rajoni nr.3, pranë Malteser-it:

- Kërkojmë që të heqim kazanët e mbeturinave nga zona e shtëpisë tonë, pranë "Malteser". Jemi 4 – 5 familje dhe e kemi shumë problem këtë gjë, sepse kazanat e vendosur aty mbledhin të gjitha mbeturinat e Gjuhapolit dhe zonës përreth. Duhet gjetur një pikë tjetër për kazanët.

Znj. Glivi Kaceri, banore në lagjen nr. 3, fillimisht falenderon për ndërhyrjet dhe punët që janë bërë deri tani sipas prioriteteve që kanë qenë . Ajo shton:

- Kemi një problematikë në bllokun e pallateve përballë varrezave katolike, rruga "Hilë Mosi", janë pallate të vjetra dhe kanë nevojë për ndërhyrje. Investimi që mund të bëhet mund të përmirësojë kushtet e jetesës, eficiencën e energjisë dhe vlerësim të këtyre pronave.

Znj.Uarda Gjekaj, anëtare e Këshillit Bashkiak dhe banore e rajonit nr.3:

- Po ripërcjell përcëri problematikat e vitit të kaluar, pasi nuk janë përfshirë akoma në buxhet. Bëhet fjalë për rrugët: "At Shtjefen Gjergjovi", Palokë Kurti" dhe "Gjergj Fishta"
- Është një nga zonat kryesore të Shkodrës, plot pallate e biznese dhe shumë fluks makinash dhe lëvizjeje, ku përveç sistemimit të rrugës është e nevojshme që të ketë edhe korsi të biçikletave sepse nuk është akoma e pajisur me korsi biçikletash.
- Në rrugën "At Shtjefen Gjergjovi" dhe "Palokë Kurti" ka shumë pallate dhe banorë, po ashtu është në ndërtim edhe një pallat i ri dhe hyrja e dalja në atë rrugë është vështirësuar, prandaj duhet gjetur një sistemim.
- Ka vite që nuk vihet dorë në këtë rrugë. Ka dy vite që e kërkojmë një investim dhe akoma nuk ka një përgjigje.
- Tek këto dy rrugica duhet të eliminohet edhe parkimi në njërin krah sepse bllokun hyrjet e shtëpive sepse janë rrugica shumë të ngushta dhe krijojnë shumë problem për kalimtarët.

Z. Deda shprehet se është në dijeni dhe e kam përcjellë këtë problematikë por edhe ju si anëtare Këshilli duhet të tregoni vëmendje për këtë zonë kaq të rëndësishme që t'i jepet qytetarëve shërbimi i duhur në këtë zonë.

Znj.Vjollca Petani, anëtare e Këshillit Bashkiak dhe banore e rajonit nr.4:

- Përsa i përket kazanave të mbeturinave që u përmenden më parë, ne kemi kontaktuar me Z.Deda dhe Z.Salihi dhe na është thënë që mund të zgjidhet. Janë duke u bërë një sërë

punësh dhe për këtë dua të falenderoj dhe përgëzoj stafin e Bashkisë dhe dëshiroj të kërkoj gjithashtu edhe mirëkuptimin e të gjithëve sepse punët e mira nuk bëhen sa hap e mbyll sytë. Di të them se sa herë që telefonojmë për problematika të ndryshme të zonën, marrim përgjigje.

- E vetmja kërkesë që kam është vendosja e një Bumi në rrugën tonë.

Znj. Ingrid Luani, banore e lagjes nr,. 3:

- Problematike për ne banorët e rrugës “Loro Kovaci”, ngjitur me parkingun dhe Malteserin, janë kazanat e plehrave, që sa herë dalim nga shtëpia shohim kazanat plot me plehra. Është një pikë shumë problematike, prandaj duhet të ketë vëmendje të shtuar, sepse është një pikë me shumë volum mbetjesh dhe duhet të menaxhohet me mirë. Për më tepër zona frekuentohet nga shumë turistë dhe është një pamje e shëmtuar.
- Në shkollën “Branko Kadaja” është bërë instalimi i kaldajave por klasa që kemi për nxënësit me AK është në fund të korridorit dhe thuhet që për arsye teknike ajo nuk është përfshirë nga ngrohja me kaldajë. Për më tepër punimet e kryera janë lënë përgjysëm dhe duhet të bëhet një verifikim përsa i përket vendosjes së kapakëve dhe mbylljes së investimit sepse kjo për nxënësit është e rrezikshme.

Sqaron nga administrata **Z.Gjozef Kullaj** duke thënë se investimet në këtë shkollë nuk kanë përfunduar akoma, por do kemi në vëmendje problematikën e klasës që ju përmendet dhe do gjejmë patjetër një zgjidhje.

Banor i pallateve pranë Bulevardit “Skenderbeg”:

- Kam një tjetër kërkesë nga banorët e pallateve pranë bulevardit “Skenderbeg”, pallate të vjetra, të cilat kanë nevojë për mbulesë me kapotë sepse për familjet banuese aty ndikojnë në efciencen e energjisë por edhe pamjen e kësaj zone.

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka **Znj.Teuta Qyteza**, Zv.Kryetare e Bashkisë mbyll takimin duke vlerësuar edhe njëherë pjesëmarrjen e të pranishmëve dhe propozimet.

SEKRETARE

Zbardhi proces verbalin :

Bekim Mema

Irma Sulishti

Sabina Danaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK






LISTË PREZENÇË
(Lagjia nr.3)

KONSULTIM PUBLIK: “Për Miratimin e Projektbuxhetit 2026 dhe Programit Buxhetor afatmesëm 2026-2028, të Bashkisë Shkodër”

Date: 19.09.2025

NR.	EMRI MBIEMRI	LAGJIA/FSHATI	KONTAKT (tel)	e-mail	FIRMA
1.	BEPIH MATHILI	SHKODËR	0672125390		
2.	Gjergj Sokoli	Shkodër	0682080875		
3.	Shpejt Petrusi	Shkodër	0693929829		
4.	Robert Tomsa	Kopim 3,	0676868008		
5.	Elmir Kacani	Kopim 3	0696316605		
6.	Belediane Nika	Amudara F/B	0674802310		
7.	Samir Mehmeti	Kopim 4/03	0683372705		
8.	ARBIANA LEPURI	"Pashko Vasa"	0676983281	andriana.freemish@gmail.com	

225-

NR.	EMRI MBIEMRI	LAGJA/FSHATI	KONTAKT (tel)	e-mail	FIRMA
9.	Adelina Shima	TR	0688563790	ashima@acpd.org.al	
10.	Merita Tejara	NUPA 3	06925458040	-	
11.	Gentjana Hoxha	R	0694686005	ghoxha@acpd.org.al	
12.	Shkëlzen Biberi	Mukoderi	0696090428	shkzber@acpd.org.al	
13.	Adil Bekari	ATV	0682484015	adilbekari@acpd.org.al	
14.	Elbiona Metushi	SHKODER	0676422472	elbionametu@acpd.org.al	
15.	Dejane Shkendi	J. Shkendi	0692024574	dejane.shkendi@acpd.org.al	
16.	Floro Malcey	B. SHKODER	0685068501	floro.malcey@acpd.org.al	
17.	Ardenis Ibrahimidi	B. SHKODER	0672000957	ardenis.ibrahimidi@acpd.org.al	
18.	Arbërita Fierhod	B. SHKODER	0689493380	arberrita@acpd.org.al	
19.	Arsoni Fierhod	B. SHKODER	0693756565	arsoni.fierhod@acpd.org.al	
20.	Altin Shkari	USHKOP	0672626866	altinshkari@acpd.org.al	
21.	ALITIM MULLIHI	N SHKOP	0687092890	alitim.mullihi@acpd.org.al	
22.	Elbirena Fierhod	Tirane	0686805406	elbirena@acpd.org.al	
23.	SHIHEN / ATIF	SHKODER	0685656568	-	
24.	Arbërita Gjerasi	Bull. Shkoderen	-	-	
25.	Arbërita Gjerasi	Tirane	0684802875	arberrita@acpd.org.al	
26.	Ingjithi Shkendi	Shkopi 3	0684825653	ingjithi@acpd.org.al	
27.	Ervin Dizdani	Koordinatori	0684063981	-	
28.					